

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Operacioni “Cooperation”: Zbardhen 6 vjedhje në Kavajë, në pranga 2 të dyshuarit
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/operacioni-cooperation-zbardhen-6-vjedhje-ne-kavaje-n-e-pranga-2-te-dyshu-i588945
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 12:25:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 12:20:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4be1ac3b0760d83af971f98a61f24e5adfce5b6a7008783268a65c2e92f5fe1d
TEKSTI	26868ceee0664ad4735d71b6fdd63c0da79ec03ed61be1ef0296f3b99f57b09d
PAMJA	b1ea13aa4efcc69cee01bdb96200a040d3f42d5a3c955679279c0b331751155c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	473f77057d3126641d09cb34eeae22326ddc9806e3a43601ffd71c20b8a60626
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	37c1183d944b9abe724532469e5e873d69da6740426bb5bc7e8618c3c9fa36bf
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/473f77057d3126641d09cb34eeae22326ddc9806e3a43601ffd71c20b8a60626>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by

English

ie [Aktorja 50-vjeçare shfaqet ne superforme nga Maldivet, pozat me bikini](#)Operacioni "Cooperation": Zbardhen 6 vjedhje ne Kavaje, ne pranga 2 te dyshuaritUEFA Nations L fundit

Operacioni "Cooperation": Zbardhen 6 vjedhje në Kavajë, në pranga 2 të dyshuarit



28 Shtator 2026, 14:20Kronika TEMA



Finalizohet në Kavajë operacioni i koduar "Cooperation", në kuadër të të cilit Policia ka zbardhur gjashtë raste vjedhjesh dhe ka arrestuar dy persona të dyshuar si autorë.

Në pranga kanë rënë L. R., 37 vjeç dhe A. H., 32 vjeç, të dy banues në Tiranë, të cilët ishin shpallur në kërkim për vjedhje. Sipas Policisë, të dy kanë precedentë të theksuar për vjedhje dhe kundërshtim të punonjësve të Policisë.

Operacioni u zhvillua nga specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Kavajë, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Durrës, pas hetimeve për identifikimin dhe kapjen e autorëve të disa vjedhjeve.

Të dyshuarit u lokalizuan nga shërbimet e Policisë teksa qarkullonin me një automjet. Efektivët u kanë bërë shenjë për të ndaluar, por ata nuk i janë bindur urdhrat dhe kanë kundërshtuar veprimet e punonjësve të Policisë. Nga verifikimet rezultoi se automjeti me targa të huaja me të cilin udhëtonin ishte i vjedhur.

Sipas hetimeve, më 24 shtator 2026, dy të arrestuarit dyshohet se kanë vjedhur një automjet në Kavajë dhe më pas janë larguar. Policia thotë se në këtë ngjarje janë ndihmuar nga L. D. dhe B. S., të cilët janë arrestuar më herët për kundërshtim me dhunë të punonjësve të Policisë.

Nga hetimet e kryera deri tani dyshohet se gjatë muajit shtator, L. R. dhe A. H., në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kanë vjedhur tre automjete në Durrës dhe dy automjete në Tiranë. Në një prej rasteve në Tiranë, pronari i automjetit dyshohet se është kanosur me thikë.

Gjithashtu, A. H. dyshohet se më 17 shtator 2026 ka vjedhur me dhunë një shumë parash, që përbënte xhiron ditore, në një pikë karburanti në Bulqizë.

Gjatë operacionit dhe periudhës hetimore janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale katër automjete, tre targa, tre çelësa automjesh, katër telefona celularë, veshje të përdorura gjatë kryerjes së vjedhjeve, si dhe mjete të dyshuara për hapjen e automjeteve.

Policia bën me dije se hetimet vijojnë për dokumentimin dhe zbardhjen e rasteve të tjera të vjedhjeve që mund të jenë kryer nga të arrestuarit.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Shpërndanin drogë në shkollat e Tiranës, gjykata lë në burg 31 të arrestuarit](#)

13:40 Kronika

[Laert Haxhiu i drejtohet Kushtetueses, kërkon rigjykim për "masakrën e Lushnjës"](#)

12:30 Kronika

VIDEO/ "Më duhen 100 mijë euro" - Tentuan të zhvasin Armando Dukën, arrestohen dy të rinjtë në Tiranë!

12:20 Kronika / 4 komente

Shtyhet seanca për vrasjen e Egli Progës, të akuzuarit kërkojnë gjykim të shkurtuar

11:50 Kronika / 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.